

LIGJ
Nr. 115/2014

**PËR NDARJEN ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE TË NJËSIVE TË
QEVERISJES VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË²**

(Ndryshuar me ligjin nr.180/2014, datë 18.12.2014)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja f, 83, pika 1, dhe 108, pika 2, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

1. Njësitë e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë janë:
 - a) bashki - 61
 - b) qarqe - 12
2. Ndarjet administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen nga ky ligj.

Neni 2

Emërtimi, shtrirja territoriale, kufijtë, qendra, njësitë administrative përbërëse të çdo njësie të qeverisjes vendore dhe nënndarjet e tyre janë të përcaktuara në hartat dhe në tabelat bashkëlidhur këtij ligji dhe që janë pjesë përbërëse e tij.

Neni 3

1. Organet e njësive të qeverisjes vendore, të konstituara pas zgjedhjeve vendore të vitit 2011 dhe me juridiksion territorial sipas ndarjes administrativo-territoriale, të përcaktuar me ligjin nr. 8653, datë 31.7.2000, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe me ligjin nr. 8654, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës", vazhdojnë funksionimin e tyre deri në konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të njësive të qeverisjes vendore në zgjedhjet e vitit 2015.
2. Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015 do të organizohen dhe zhvillohen mbi bazën e ndarjes administrativo-territoriale të përcaktuar në këtë ligj.
3. Organet e qeverisjes vendore, të konstituara pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015, do të organizohen dhe funksionojnë bazuar në ndarjen administrativo-territoriale të përcaktuar në këtë ligj.

Neni 4

1. Ligji nr. 8653, datë 31.7.2000, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, shfuqizohet.

² Për t'u njohur me ndarjen administrative sipas materialit bashkëlidhur ligjit nr.115/2014, mund të konsultoni Fletoren Zyrtare nr.137, datë 1 shtator 2014.

Ligji nr.180/2014, datë 18.12.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare 211, datë 14 janar 2015.

2. Ligji nr. 8654, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës", shfuqizohet me konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të Bashkisë së Tiranës pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 31.7.2014

LIGJ
Nr. 8669, datë 26.10.2000

PËR CENSUSIN E PËRGJITHSHËM TË POPULLSISË DHE TË BANESAVE³
(Ndryshuar me ligjin nr.10 084, datë 23.2.2009; aktin normativ nr. 6, datë 30.9.2009; ligjin nr.10 442, datë 7.7.2011)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i censusit

(shfuqizuar pika 3 me ligjin nr.10 442, datë 7.7.2011)

1. Censusi synon t'u ofrojë Kuvendit, Qeverisë, njësisë të qeverisjes vendore, organizatave ekonomike, shkencore dhe kulturore, si dhe gjithë shoqërisë civile të dhëna të besueshme statistikore, të nevojshme për planifikimin dhe realizimin e politikave të përgjithshme të zhvillimit, për analizat private dhe publike të vendimmarrjes, për kërkime shkencore dhe, në përgjithësi, për përmirësimin e njohjes dhe të të kuptuarit nga shtetasit të realitetit demografik, ekonomik dhe shoqëror të vendit.

2. Censusi ofron të dhëna për:

- a) numrin dhe shpërndarjen gjeografike të popullsisë rezidente (banuese);
- b) strukturën demografike dhe karakteristikat kryesore të popullsisë;
- c) numrin, shpërndarjen gjeografike dhe strukturën e banesave dhe të ndërtesave, që përdoren për qëllime banimi;

³ Ligji nr. 8669, datë 26.10.2000 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 36, datë 15 nëntor 2000.

Ligji nr.10 084, datë 23.2.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 32, datë 25 mars 2009.

Akti normativ nr. 6, datë 30.9.2009 miraturar me ligjin nr. 10 176, datë 29.10.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.143, datë 8 tetor 2009.

Ligji nr.10 442, datë 7.7.2011 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 1 gusht 2011.